



Prokuroria për policin e vrarë sot: Iu shkrep arma zyrtare



16/03/2022 16:03



Një zyrtar policor, 44 vjeçar humbi jetën sot si pasojë e plagës së marrë nga arma e zjarrit.

Burim Tahiri është zyrtari policor që vdiq aksidentalisht pasi i është shkrepur arma zyrtare.

Nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë kanë deklaruar se i njëjti ishte dërguar menjëherë në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, ku edhe është konstatuar vdekja e tij, transmeton [lajmi.net](#).

“Prokuroria Themelore e Mitrovicës njofton opinionin se sot rreth orës 10.30 në poligonin e gjuajtjes të policisë në fshatin Cërrnushë të Mitrovicës, një polic me initiale B.T 44 vjeç., deri sa ka qenë në gjuajtje në kuadër të një trajnimi të rregullt, aksidentalisht i është shkrepur arma zyrtare dhe për pasojë është plagosur dhe është transportuar menjëherë në Spitalin Rajonal në Mitrovicë ku personeli mjekësor ka konstatuar vdekjen e tij.”, thuhet në njoftim.

Prokuroria ka bërë të ditur se në vendin e ngjarjes ka dalur prokurori kujdestar dhe sipas informacioneve të para, rasti ka ndodhur aksidentalisht.

“Trupi i pajetë i të ndjerit me urdhër të prokurorit është dërguar për autopsi në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë”./[Lajmi.net/](#)

[Ky është polici që u vra aksidentalisht sot në Mitrovicë](#)

Artikuj të ngjashëm



March 16, 2022

Operacioni “Pika”: Gjykata merr vendim edhe për 24 zyrtarët tjerë të...



March 16, 2022

Bombardohet teatri në Mariupol, brenda ishin të strehuar qindra civilë



March 16, 2022

Reagon Ukraina, hedhë poshtë pretendimet e Financial Times për “planin 15...



March 16, 2022

Nisin hetimet edhe ndaj një ministreje të Kurtit: Donika Gërvalla “nën...



March 16, 2022

Dështoi miratimi i Kodit Civil, deputetja e AAK-së: Mbrojtëm familjen tradicionale...



March 16, 2022

Grenell i reagon senatorit amerikan që i kërkoi pesësches së BE-së...

LAJME TË FUNDIT



Romano: AC Milan ka më shumë se interesim...



Operacioni “Pika”: Gjykata merr vendim edhe për 24...



Formacionet zyrtare: Brighton – Tottenham



Gold Ag “eskalon” ndaj deputetëve që votuan pro Kodit Civil



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE

